



Republika e Kosovës
Komuna Drenas/Gllogoc
Kuvendi i Komunës



02-Nr. 020/04-14930 dt. 28.03 2023

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40, pika 40.2 shkronja e) dhe i) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Gllogocit në mbledhjen e rregullt e mbajtur më, **28.03.2023**, miraton këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit.

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit në këtë përbërje:

1. Valentina Gashi Leku
2. Jahir Hajdari
3. Drin Halilaj
4. Laurita Muhadri Bujupi
5. Egzon Qorri

Neni 2

Me këtë vendim obligohet komisioni që të bëjë shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtimin e rrugëve dhe pas shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe ankesave komisioni harton raportin dhe i propozon kuvendit listën për aprovim.

Neni 3

Me këtë vendim obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor që të bëjë regjistrimin për emërtim të rrugëve që merr vendim kuvendi për ndryshim apo emërtim të ndonjë rruge të re.

Neni 4

Mandati i komisionit përfundon me përfundimin e mandatit të asamblistit.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen e Komunës.

Plani i dërgohet:
Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

Arsyetim

Edhe pse komisioni paraprak ka bërë një punë të mrekullueshme dhe në mbledhjen e fundit të mandatit ka dorëzuar propozimet pas shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, kërkesave për riemërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit, puna nuk ka arritur të finalizohet për shkak të ligjshmërisë së vendimit të kuvendit për këtë çështje, përkatësisht propozimeve për emërtim dhe ri-emërtim të rrugëve.

I tërë emërtimi dhe riemërtimi të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike që ndryshe quhen “Zona për Qarkullimin Publik” duhet të bazohet në Ligjin Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave dhe në aktet nënligjore të këtij ligji në cilat parashihen edhe ndryshimet të cilat ndodhin në hapësire, zhvillimet e reja urbane, rrugët e reja, rastet kur rrugët duhet ose mund të ri-emërtohen etj.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe komuna ka pranuar një numër kërkesash për këtë qëllim.